

Aktivitetet e kryera nga Shoqata Gazetarë Profesionistë Rajonalë në zbatim të nëngrantimit në kuadër të projektit “Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë – Luftimi i Kontrabandimit të Migrantëve në Ballkanin Perëndimor”, mbështetur financiarisht nga Komisioni European.

1. Promovimi i projektit me pjesëmarrjen e aktorëve relevantë (publikut, gazetarëve, punonjësve të policisë kufitare dhe kriminale, punonjësve të administratës publike) ku do të prezantohet projekti, objektivat e rezultatet e tij, etj. Një kronikë televizive dhe mediat sociale do të pasqyrojë promovimin e projektit.
2. Transmetimi i një spoti televiziv për një periudhë një mujore në televizionin lokal “TV-Lobi” për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me parandalimin e emigracionit të paligjshëm dhe nxitjen e kurajës së tij për denoncimin në polici të rasteve të këtij fenomeni.
3. Katër vëzhgime gazetareske në katër pikat e kalimit kufitar (Kapshticë, Tre Urat, Qafë Thanë dhe Tushemisht) në lidhje me investigimin e fenomenit të emigracionit të paligjshëm.
4. Ëorkshop në qytetin e Korçës, i ilustruar me vëzhgime gazetareske, me pjesëmarrjen e punonjësve të policisë kufitare dhe kriminale, juristëve, përfaqësuesve të bashkisë dhe gazetarëve, në lidhje me dënimet që parashikon ligji për emigracionin e paligjshëm dhe masat që duhet të marrë policia dhe pushteti lokal për parandalimin e këtij fenomeni.
5. Forum televiziv prej 45 minutash në TV Lokal, në lidhje me investigimin e fenomenit të emigracionit të paligjshëm në bashkitë e Korçës, Pogradecit, Maliqit, Devollit, Ersekës dhe Pustecit, në panelin e të cilit do të bëjnë pjesë përfaqësues të drejtorisë së polisë, përfaqësues të pushtetit lokal, të taksistëve të licensuar, shoqëruar me opinione të publikut.
6. Peticion i taksistëve të licensuar drejtuar Prefekturës së Korces lidhur me problematikat që shkakton lejimi i ushtrimit të veprimtarisë së taksive të palicensuara nga bashkitë repektive dhe konkurrencës së pandershme që ato zhvillojnë në raport me taksitë që janë licensuar konform ligjit.
7. Raport investigativ dërguar Drejtorisë së Policisë së Qarkut të Korçës për gjetjet gazetareske të evidentuara gjatë fazave të projektit, lidhur me fenomenin e emigracionit të paligjshëm, shkaqet për parandalimin e këtij fenomeni dhe rrugët e zgjidhjes së tij.
8. Konferencë mbi rezultatet përfundimtare të projektit, me pjesëmarrjen e gazetarëve të mediave lokale dhe kombëtare, taksistëve të licensuar, nëpunësve të administratës publike, policisë kufitare dhe policisë kriminale dhe publikut